

01-1277

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 dhe të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.391/02-102379/25 dt. 15.07.2025, të pronarit Dion Shala nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për hapësirën garazhuese të shndërruar në hapësirë afariste, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 25.07.2025, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LEJOHET** pronarit Dion Shala nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-102379/25 dt. 15.07.2025, përdorimi i hapësirës garazhuese të shndërruar në hapësirë afariste, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale O-71914059-783-1-2-0, me sipërfaqe prej 19.80 m², Zona Kadastrale Prishtinë e cila ndodhet në katin përdhese të ndërtesës shumë banesor me etazhitet P+4ET, në Lagjen “Kodra e Diellit”, rruga “Fadil Ferati” K-P, H-1, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-154128/23 dt. 14.08.2013 të lëshuar nga kjo Drejtori.
- II.** Hapësira e shndërruar nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Sylejman Vokshi” hyrja nr. 1 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e hapësirës banesore të shndërruar në hapësirë afaristë në evidencat e regjistrit kadastral.
- IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari/investitori Dion Shala nga Prishtina me kërkesën me 05 Nr.391/02-102379/25 dt. 15.07.2025, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për hapësirën garazhuese të shndërruar në hapësirë afariste, e cila ndodhet në katin përdhese të ndërtesës shumë banesor me etazhitet P+4ET, në Lagjen “Kodra e Diellit”, rruga “Fadil Ferati” K-P, H-1, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-112434 dt. 05.08.2015, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-78488/25 dt. 03.07.2025, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes dhe Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Jetik Doli ; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Rexhep Salju;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht hapësira garazhuese e shndërruar në hapësirë afariste mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që hapësira garazhuese e shndërruar në hapësirë afariste mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për hapësirën e lartëcekur.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkesit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-102379/25 DT. 25.07.2025

Zyrtari,
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

